



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 12.1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 12.12.2013 për shqyrtimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2014 – 2023”

**në seancën e mbajtur me datë 23 dhjetor 2013, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **I Aprovohet “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2014 – 2023”**

#### **Arsyetim**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 12.12.2013 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2013 – 2022” të KOSTT SH.A. Dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e KOSTT për diskutim publik. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë pranuar, sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Pas përfshirjes së komenteve, ZRrE vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara dhe aprovon “Planin Zhvillimor të Transmisionit 2014 – 2023” me vërejtjet si më poshtë:

- **Paket Projekti - “UNAZA 400kV Gjakovë – Prizren – Ferizaj”:** projekti parashihet në fund të afatit që përfshinë dokumenti, është me një kosto të lartë, prandaj ZRrE mendon se duhet pasur kujdes në iniciimin e këtij projekti, dhe kërkohet të studiohet në hollësi fizibiliteti i investimit për një projekt të tillë.
- **Linja e re 110 kV Peja 3 - HC Ujmani:** projekti parashihet afër fundit të afatit që përfshinë dokumenti, dhe ZRrE mendon se vendimi përfundimtar për këtë projekt duhet të përcaktohet varësisht prej zhvillimit dhe sigurisë së sistemit, prandaj për këtë kërkohet të analizohet fizibiliteti i investimit.

**II** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

**Plani Zhvillimor i Transmisionit 2014 – 2023**



III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

Envër Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar